

NE BRENDESI / PREC ZOGAJ ARTUR ZHEJ SOKOL BALLA FABIAN ZHILLA AJOLA XOXA ARTAN LAME AURON TARE

# MAPO

REVISTA

**EUROBOND  
APO XHEJMS BOND!**

**MOCIONET**  
OPOZITA SYNON  
BERISHËN DHE TOPALLIN

INTERVISTA - BUJAR XHAFFERI  
"ZOTI NUK EKZISTON  
NË KOHËN E TANISHME"

**LEKA ZOGU**  
"Shqipëria  
është në rrezik"

**EKSKLUZIVE** Pretendentitë fronit thotë për MAPO  
se e ka fituar referendumin e '97-ës.  
"Grekëve s'do u bëja dhuratën më të vogël"

**DOSSIER**

240 violinat  
shqiptare  
nëpër botë

FAQE 26-27

Së shpejti kthimi i eshtrave  
Shahin Toçi, shqiptari  
që refuzoi Musolinin

FAQE 19

Pronto!  
Ju flasim  
nga Tirana

FAQE 30-31

FOTOGRAFIA: JUTTA BENZENSBERG

Një vrasje e shëmtuar tronditi në 26 majin e vitit 1939 rrugën Trastevere në Romë. Një i ri shqiptar, me emrin Shahin Toçi, i sapodiplomuar në Akademinë Ushtarake, u gjend i vdekur nga autoritetet italiane. Shumë hipoteza do të hidheshin për shkakun e vdekjes, shumë pikëpyetje qëndronin rreth shkakut të saj, por e vërteta mbeti e pazbuluar. Shteti italian e arshivoi dosjen Toçi, ndoshta për të fshehur atë që kishte ndodhur realisht, e që kishte lidhje me aktin e madh patriotik të këtij shqiptari nga Mati.

Dy javë para se të gjendej i vranë, Shahin Toçi kreu një gjest i cili sot, në distancën e 70 vjetëve, rrezaton patriotizëm dhe burrëri të spikatur. Është pikërisht ai qëndrim i fortë prej shqiptari patriot, i cili ndoshta i kushtoi jetën, në mesin e një Italie të pushtuar nga ethet e fashizmit dhe të dominuar nga këmishat e zeza. Megjithatë, para se të komentojmë vdekjen e tij, le të shohim cili që dhe çfarë përfqësonte ky djalosh i ri 21 vjeçar.

I lindur në 30 tetor 1918, Shahini do të shquhej shpejt për cilësitë e tij Jeta e Shahin Toçit, peripecitë e studimeve në Itali dhe përgjithësisht egzistenca e tij në pjesën e fundit të jetës, kanë qenë një dramë e vërtetë, e cila zhvillohej larg atdheut dhe që përfshinte dinamikën e ngjarjeve të turbullta për Shqipërinë, në vitin 1939. I rreshtuar, edhe për shkak të prejardhjes, në krah të Mbretit Zog, Shahin Toçi do të provonte një dilemë të fortë të brendshme, në ditët kur Italia do të pushtonte vendin tonë dhe kur i gjithë sistemi shqiptar i vlerave tradicionale do të hynte në krizë. Në debatet mes studentëve shqiptarë, veçanërisht të ndezura në ato momente, ai tregoi gjithnjë i kujdesshëm, për të mos i lënë vend interpretimeve të lehta e sipërfaqësore. Ishte i bindur se mes propagandës fashiste dhe në një largësi aq të madhe nga vendi, ngjarjet, faktet dhe e vërteta e pushtimit vinin të shtrëmbëruara, emotive dhe subjektive. Megjithatë Shahini që ndër të parët që hodhën idenë e organizimit të studentëve, për t'u kthyer në Shqipëri dhe për të luftuar për çlirimin e vendit. "Këta që flasin me fjalë të bukura dhe që e mbajnë veten të qytetëruar, në fakt justifikojnë robërinë e popujve", shprehej ato ditë Shahin Toçi. "S'ka mbetur rrugë tjetër, veçse të hedhim armët dhe rroben fashistë, e të kthehemi në atdheun tonë. Atje s'ka humbur besa, as burrëria. Atje mund të organizohemi edhe më mirë, për të hedhur tutje robërinë". Me këto fjalë në gojë, ai debatonte papushim me studentët e tjerë, të cilët i bindeshin pa shumë rezistencë ideve fashiste.

Shahin Toçi do të shihte gjithë dëshpërim momentin kur kurora mbretërore shqiptare do të dorëzohej në Romë nga garda kombëtare, çka do të përjetohej nga ai si një tragjedi e brendshme. Megjithatë, Shahin Toçi diti të qëndrojë si një shqiptar i fortë edhe në ato ditë të vështira, edhe larg vendit të tij.

Më fillim të majit 1939, studentët



Shahin Toçi gjatë studimeve në Romë (i pari duke filluar nga e djathta)

## Shqiptari që refuzoi betimin e Musolinit

Më 26 maj 1939 u gjend i vranë në rrugën Trastevere në Romë studenti shqiptar Shahin Toçi, i cili pak ditë më parë kishte refuzuar të bënte betimin fashist në Akademinë Ushtarake. Vdekja misterioze e një të riu që guxoi të sfidojë autoritetet italiane pak ditë pas pushtimit të vendit tonë

të plotë të Romës. Sipas programit, betimi do të bëhej në një nga sheshet e kryeqytetit italian, në datën 13 maj 1939.

Ditën e betimit, në një ceremoni të blinduar nga trupat italiane, ku merrte pjesë dhe nënsekretari i luftës Pariani, studenti Shahin Toçi u paraqit me një shirit kuq e zi, mbi uniformën ushtarake italiane. Ky simbol krijoi përshtjellim të dukshëm tek oficerët e lartë që ishin prezent në ceremoni, të cilët i kërkuan të riu nga Shqipëria të hiqte menjëherë shiritin kuq e zi. Ishte gjeneral Pariani, ai që u habit më shumë nga ky gjest. "Ç'vlerë ka kjo uniformë, mbreti juaj ka rënë", iu drejtua ai Toçi. "Edhe mbretërit mund të bien", u përgjigj Shahin Toçi, "edhe uniformat mund të ndërrohen, por ky shirit mbetet". Dëshmitarët e atij momenti thonë se gjenerali italian heshti pas replikës së të riu. Në të kundërt, studentëve shqiptarë iu kërkua që të nesërmen të rreshtoheshin sërish, për të recituar formulën e betimit fashist. Kur oficeri nisi të lexonte me zë të lartë



Është e tepërt të thuhet se ceremonia u prish për herë të dytë. Aq sa të nesërmen, studentëve iu kërkua të paraqiteshin para një komisioni në Ministrinë e Luftës, për të firmosur (dhe jo thënë me zë të lartë), tekstin e betimit ushtarak fashist. Një dorë e kujdesshme e mbajti larg me forcë studentin Shahin Toçi tek dera e hyrjes: E dimë qëndrimin tuaj arrogant, ju nuk pranoheni këtu, iu tha atij në portat e ministrisë së Luftës.

Në këto kushte studenti kurajoz kishte vetëm një ide fikse në kokë; të kthehej sa më parë në Shqipëri. Por nuk do ta realizonte dot dëshirën e tij. Një dorë e padukshme i mori jetën një natë të fund-majit 1939, në bujtinën ku banonte në rrugën Trastevere. Është pak ta quash një vdekje të dyshimtë, për nga mënyra sesi u konsumua dhe për nga mesazhi frikësues që mban brenda. Gjithsesi, humbja e Shahin Toçit ato ditë të para pas pushtimit fashist, shënon një ngjarje deri dje pak të njohur, e cila na tregon sesa shumëformëshe dhe komplekse ka qenë rezistenca e shqiptarëve ndaj pushtimit të ven-

www.revistamapo.com  
Greqi 2 Euro

BRENDA / PREÇ ZOGAJ AURON TARE FJODORA FJORA MARK MARKU ANDI BUSHATI ARTAN LAME BETI NJUMA

# MAPO

REVISTA

**RAMA-BASHA**  
STINË HILESH  
NË TIRANË

**ALEKSANDËR MEKSI**  
VITET E MIANË  
"IMONINE QEVERISË"

## Skaneri i zgjedhjeve Kush fiton në 8 maj?

gazetarët e njohur Sokol Balla, Blendi Fevziu dhe Alfred Peza analizojnë fushatën  
zgjedhjeve vendore. Sfidat, pikëpyetjet dhe nyjet e pazgjidhura të një përballjeje të ashpër

**REPORTAZH**

Kosova, viti dymbëdhjetë

**SHAHINTOÇI**

Rikthehet pas 70 vjetësh

**LORIK CANA / INTERVISTA**

"Pas futbollit do të merrem



# SHAHIN TOÇI

## Rikthim pas 70 vjetësh

Exhtrat e Shahin Toçit prekën tokën shqiptare, për herë të parë pas 70 vjetësh. Pas një përpjekjeje të gjatë nga familjarët e tij, nga autoritetet qendrore në Tiranë dhe ato lokale, si dhe nga deputeti i zonës, exhtrat e këtij djali të shquar nga Mati u rikthyen në vendlindjen e tij

Konkretisht edhe në parë për një personazh historik, i cili e ka kryer detyrën e tij ndaj atdheut në një kohë dhe në një mjedisi të ashpër. Kur në të në dorë historia e Shahin Toçit, oficerit trim nga Mati, kujtuam për një rast veçanërisht të bërimit me një precedent të njohur. Por nuk ishte aspak kështu.

Ky djali i lindur në Dajç të Matit, në vitin 1914, për bëri një rast krijt të veçantë, heroik, njerëzor dhe shumë prekës, të një njeriu që preferoi të ruante genin shqiptar, t'i përkushtohet prejardhjes së tij dhe asaj që besonte thellë në shpirt, përballë një fuqije të madhe e shtypëse, siç ishte në atë kohë Italia fashiste.

Kush ka lexuar shkrimin tonë paraardhës për Shahin Toçin, ka mësuar se ai ka qenë një student i Akademisë Ushtarake të Modena në Itali, në vitet 1937-1938. Pas kësaj kryer studimet, është kthyer të punojë në Ministrinë e Mbrojtjes të asaj kohe në Shqipëri dhe është



● Momenti ardhës në Shqipëri të exhtrave

oficerëve të tjerë. Shahin Toçi nuk pranon të betohet para flamurit italian, por mbron flamurin e vendit të tij.

gjatë nga policia sekrete fashiste. Varrimi i tij u bë fshihurasi nga autoritetet italiane më 25 maj 1938. Shahin Toçi ishte doktrinar